ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Nr i Prokurimit	**204-22-10111-5-1-1**
Nr i brendshëm	**MINT204-22-058-511**

Sa i përket tenderit për: **"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i Operatoreve Ekonomik: "INVEST PRO" SH.P.K & "TRASING GROUP" SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Uglarit p.n.
(Adresa)

Fushë Kosove — ***12000***
(Vendi) — ***(Kodi postar)***

049/955-735
(Numri Telefonit) — ***(Numri i Faks-it)***

Rijad Ramadani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

investprorks@gmail.com
(Adresa elektronike)

05.01.2023

R. Ramadani

SH.P.K. INVEST PRO Fushë Kosove

(Data e parashtrimit të ankesës) — ***(Nënshkrimi dhe vula)***

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 04.10.2022 Data e hapjes së ofertave: 18.10.2022 Njoftimi mbi vendimin: 22.12.2022 Kërkesa për rishqyrtim: 27.12.2022 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt: 28.12.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ju njoftojmë se me datë 22.12.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është shpallur fitues OE "Pro & Co Group SHPK" ndërsa neve jemi eliminuar, me arsyetimin se : ***Ju keni ofruar letër mbështetjen nga banka BKT mirëpo këtij dokumenti të bankës i mungojnë edhe disa të dhëna të rëndësishme si numri protokollit të lëshuar nga kjo bankë sipas rregullave si dokument zyrtar i bankës, i mungon emri dhe mbiemri i zyrtarit që e ka aprovuar këtë dokument apo emri dhe mbiemri i menaxherit në pikën e lëshuar Skenderaj".***

Fillimisht ju sqarojmë se ky arsyetim nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në fakte konkrete dhe dëshmitë e ofruara nga ne si OE.
Ne ju konfirmojmë se dokumenti i lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare me datën 14.10.2022 lidhur me mbështetjen bankare është dokument origjinal, e cila mban vulën origjinale të bankës së lartcekur dhe nënshkrimin zyrtar.
Për më tepër, ju sqarojmë se kërkesë në dosje të tenderit tek neni 8.1&8.2 i FDT-së ka qenë **1.Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akces në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€,** kurse dëshmi e kërkuar dokumentare ka qenë : **Dëshmia – 1 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt.**
Pra, nëse bazohemi në kërkesë dhe në dëshminë e kërkuar dokumentare vërehet qartë se dokumenti nga banka nuk është kërkuar që të ketë ndonjë të dhënë tjetër specifike, përveç se i nënshkruar dhe vulosur lidhur me këtë projekt.
Edhe dokumenti që ne kemi bashkangjitur me ofertë ka qenë i nënshkruar dhe vulosur lidhur me këtë projekt, prandaj rezulton se dëshmia nga banka ka qenë pikërisht konform kërkesës së dosjes së tenderit.
Me këtë veprim, autoriteti kontraktues ka rënë ndesh me dispozitën e nenit 56.3 të LPP-së sepse na ka eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë në dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontratë (nuk është kërkuar që të figuron emri i personit që nënshkruan e as numër i referencës).

Po ashtu nëse autoriteti kontraktues ka pasur çfarëdo dyshimi apo dileme në lidhje me origjinalitetin e dokumentit zyrtar të bankës, ka mundur të kërkoj drejtpërdrejtë informacion ose sqarime shtesë nga menaxhmenti i bankës përkatëse.
Pra autoriteti kontraktues ka mundur të shfrytëzojë dispozitën e nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së që të kërkojë sqarime eventuale nga Banka, nëse më të vërtetë ka pasur ndonjë dilemë me dokumentin e lëshuar nga Banka, e jo të na eliminojë neve pa ndonjë sqarim (edhe pse dëshmia nga Banka ka qenë konform kërkesës së FDT). Po ashtu ka mundur të kërkojë sqarime shtesë edhe nga ne si operator ekonomik ofertues dhe njëkohësisht më çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë.

Pavarësisht që dokumenti nga Banka ka qenë sipas kërkesës, ne kemi kërkuar sqarime nga banka dhe kemi pranuar edhe një konfirmim zyrtar nga banka lidhur me dokumentin për te cilin jemi eliminuar dhe të njëjtit pra BKT e konfirmon se dokumenti është zyrtar dhe i lëshuar nga banka përkatëse me të dhënat e nevojshme.
Në konfirmimin e lëshuar nga Banka janë te specifikuara gjitha shënimet se nga kush është lëshuar dokumenti i datës 14.10.2022.
Konfirmimi nga Banka është i bashkangjitur më poshtë, ku mund të vërtetohet saktë se dokumenti është origjinal dhe i padiskutueshëm.

BKT Kosovë
Dega. Skënderaj
Date: 23.12.2022

Prot.no 753 / 937

VERTETIM

Me anë te këtij dokumenti vertetojmë se Leter Mbeshtetja e leshuar me datën 14.10.2022 per klientin **Trasing Group SH.P.K.** me **NUI 810514275** eshte leshuar zyrtarisht nga banka BKT Kosova dega Skenderaj.

Kjo Leter Mbeshtetese eshte nenshkruar nga Analisti i Biznesave - Berat Daraka i cili eshte kompetent per leshimin e këtij dokumenti.

Leter Mbeshtetja eshte per projektin me titull " **Ndërtimi infrastrukturës fizike te Zonës Ekonomike ne Oylagë - Faza e IV-te** " me nr te prokurimit: **204-22-10111-5-1-1** dhe numer i brendshem **MINT204-22-058-S11**.

Vërtetuar nga:
Ass. Operations Menager
Mihane Veliqi

Pra duke pasur parasysh faktet dhe dëshmitë e ofruar nga ne si OE i përgjegjshëm dhe më ofertën me çmimin më të lire në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë, dëshmohet se arsyeja e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së dhe me kërkesat e FDT-së.

Ne pajtohemi me arsyen e eliminimit të OE B Famis SHPK, i cili është eliminuar me arsyetimin

1. Në kuadër të ofertës tuaj ju nuk keni ofruar raportet mbi gjendjen financiare për tri vitet e fundit të audituara ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.
2. Në kuadër të ofertës tuaj ju nuk keni ofruar listen e stafit mbështetës ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.
3. Planin dinamik qe keni ofruar nuk eshte ashtu sic eshte kërkuar ne njoftim per kontrate si periudhë e përfundimit të projektit per 120 dite, mirëpo ju keni ofruar planin me përfundimin e punimeve për 24 muaj.

Më dt. 28.12.2022 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së sa i përket kërkesë për rishqyrtim të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar.

AK-ja e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim duke u arsyetuar si në vijim:
"Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit te afatit për dorëzimin e tenderëve.

Mbi bazën e kësaj ju ne kërkesën për Rishqyrtim keni ofruar dokumentin e bankës jo ne përputhej me legjislacionin ne fuqi sepse data e ofrimit te këtij dokumenti është jo vetëm se para hapjes se ofertave por edhe pas përmbylljes se procesit qe ka rezultuar me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues pra me date 22.12.2022 ndërsa ju me ketë dokument jeni pajisur pas pranimit te njoftimit si tenderues i eliminuar pra me date 23.12.2022 qe me ketë rast është krijuar një dokument i ri edhe ne datën e dokumentit por edhe ne numrin e protokollit pas mbylljes se procesit , gjithashtu me ketë rast ju vetëm se po e pranoni se një dokument te tille zyrtar nuk e keni ofruar ashtu siç është kërkuar"

Ky konstatim i AK-së është i pa saktë dhe i pa qëndrueshëm, për më tepër tendencioz sepse nuk pasqyron realitetin në lidhje me këtë lëndë.
Sa për rikujtim, ne kemi ofertuar me dëshmi të Bankës ashtu siç ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë, pra dëshmia nga Banka është ofruar 100% konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe normalisht nuk ka pasur nevojë të kërkohen sqarime shtesë fare në lidhje me këtë dokument. Pra në momentin që na keni eliminuar, ju keni vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Pas pranimit të letrës standarde për tenderues të eliminuar, ne kemi kërkuar një sqarim nga Banka në lidhje me dokumentin që e kishte lëshuar banka dhe të cilin ne e kishim bashkangjitur në ofertë. Sa për korrektësi, ne nuk kemi kërkuar dokument të ri, por kemi kërkuar sqarim, kurse Banka ka lëshuar vërtetimin sqarues me dt.23.12.2022 në lidhje me dokumentin e Bankës të lëshuar me dt.14.10.2022. Pra vërtetimi i dt.23.12.2022 e sqaron dhe e konfirmon origjinalitetin dhe saktësinë e dokumentit të lëshuar me dt.14.10.2022 dhe ky sqarim normalisht që lëshohet me datën kur bëhet sqarimi, por sqarimi është bërë për një dokument i cili ishte lëshuar para datës së ofertimit dhe ky sqarim nuk përbën ndryshim material por është konfirmim mbi origjinalitetin e dokumentit i cili ishte dorëzuar me ofertë.

Po ashtu, arsyetimi se këtu kemi të bëjmë me dokument të ri dhe se nuk vihet në zbatimi Neni 72 i LPP-së, është i pa qëndrueshëm, sepse ne kemi ofruar vërtetim sqaruese në lidhje me dokumentin të cilin AK-ja fillimisht e ka konsideruar si dokument jo valid, prandaj ne nuk kemi ofruar asnjë dokument të ri, mirëpo kemi ofruar vërtetim sqarues për ta konfirmuar dokumentin zyrtar të cilin e ka lëshuar banka. Dhe e gjithë kjo ka ardhur si pasojë që AK-ja nuk i është përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së, fillimisht nenit 56.3 dhe më pastaj Nenit 72 paragrafi 2 "*Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji*".

Autoriteti kontraktues ndër të tjera në vendimin për refuzim e ka cekur se "*për korrektësinë e procedurës edhe pse ju keni ofruar dokumentin e datës 23.12.2022 nga banka ne brendësi te tij keni kundërthënien e kjarte sepse këtu thuhet qe Letër mbështetja është nënshkruar nga Analisti i Bizneseve Berat Duraku si person përgjegjës, ndërsa ne dokumentin e bankës qe ju keni prezantuar ne oferte askund nuk përmendet emri dhe mbiemri i tij por gjithashtu ai dokument nuk ka as date te protokollimit si dokument ashtu siç kjo bankë i ka rregullat e brendshme qe iu referohet dispozitave ligjore te Bankes Qendror te Kosovese. Si krahasim te këtij dokumenti kemi marre ofertat e 0E te tjerë pjesëmarrës ne te njëjtën procedure për te njëjtën banke dhe shifet kjarte se dallojnë këto dokumente pra nuk janë te formatit njëjtë për nga mënyra e lëshimit te dokumentit dhe se nuk mund qe banka e njëjtë te ketë standarde te ndryshme për OE te ndryshëm për dokumentin e njëjtë*".

Ky arsyetim i AK-së është i pa qëndrueshëm, jo profesional dhe shumë subjektiv duke tentuar që të zhvleftësojë edhe vërtetimin sqarues të Bankës. Vetë Banka e ka sqaruar se kush e kishte lëshuar dokumentin e dt.14.10.2022, i cili dokument e ka përmbajtur nënshkrimin, prandaj përderisa ka qenë nënshkrimi i një personi zyrtar, Banka në këtë rast ka bërë sqarim se kush e ka nënshkruar këtë dokument dhe në këtë rast autoriteti kontraktues merret me çështje jo esenciale dhe nuk merret me përmbajtjen e dëshmisë nga Banka dhe me faktin se a plotësohet kërkesa me dëshminë bankare apo

jo. Në këtë rast, vetë autoriteti kontraktues merr përgjegjësi më shumë se sa vetë personat zyrtar të Bankës, madje konteston dokumentet të cilat i ka lëshuar banka e që përsëri i konfirmon të njëjtat. Ky arsyetim i AK-së, nuk ka se si të kuptohet ndryshe përveç se tendencë e pastër ndaj kompanisë tonë dhe favorizim i hapur i kompanisë fituese.

Pavarësisht të gjitha tendencave dhe përpjekjeve për të na eliminuar nga konkurrenca, edhe njëherë e sqarojmë se në këtë rast, as nuk ka pasur nevojë për sqarime shtesë dhe as nuk kemi mundur të eliminohemi nga konkurrenca, sepse kërkesa e FDT-së ka qenë që dëshmia nga Banka të jetë e nënshkruar dhe e vulosur, dhe nuk ka qenë e specifikuar se duhet të figurojë emri i personit që ë nënshkruan, e as numri i referencës, prandaj ne jemi eliminuar pa të drejtë në këtë procedurë të prokurimit.
Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**
Ne në këtë procedurë kemi ofertuar me çmim prej 633,358.58 euro, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 688,835.12 euro. Pra në këtë rast autoriteti kontraktues rrezikon ta dëmton buxhetin në vlerë prej **55,476.54 euro,** pa asnjë arsye të vetme. Veprimi i autoritetit kontraktues bie ndeshe dhe me nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet që kjo dispozitë parasheh që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike

Gjithashtu AK nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu AK nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e Grupi i Operatoreve Ekonomik: **OE INVEST PRO SH.P.K. & TRASING GROUP SH.P.K.**
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së, si dhe lënda kthehet në
RIVLERËSIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim, ankesave etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PPQDD111111111H

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	INVEST PRO SH.P.K.
Përshkrimi Opis Description	ANKES
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	204-22-10111-5-1-1
Shuma / Iznos Ammount	€ 5000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 06 01 23
Me fjalë / Rečima In words	Pesë mijë euro e zero cent
Xhirollogaria Broj žiroračuna Bank account	1000430070005756
Lëshuar nga Izdato od / Issued by	OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.

WF-01

00201315270

NLB BANKA Prishtinë

OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit

WITHDRAWAL FORM

1700-0736-000001.09

Emri i klientit/ *Customer name:* INVEST PRO SHPK

Llogaria nr/ *Nr.llog.* 1701-0174-005728.73

Saldo / *Balance:* Gjëndja

Në llogarinë/Account 5,001.50 EUR Provizio

Me fjale: pesëmijënjë e
In words: *fivethousando*

Exchange rate/Exchange rate 1.0000

Uniref Acc.: 1000-4300-700057.56 Uniref Name: OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit

Emri Mb,Kompania INVEST PRO SHPK
Përshkrimi ANKESE NR.PROKURIMIT 204-22-10111-5-1-1

UNIREF PPQDD1111111111H

Përshkrimi

Trader name: INVEST PRO SHPK
NUI: 811910258

06.01.2023
Data / *Data*

0 5054 1 334 06.01.2023 12:46
Nënshkrimi digjital

R. Ramadani

Nënshkrimi /ı.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE
No./Br./No 8000/03 Nr.Faq/Br.str/No.pg 3
Data/Datum/Date 28.12.22
POSHTË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada -Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Datë : 28/12/2022

Në mbështetje të nenit 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 8 të Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga Operatoret Ekonomik **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k** përmes sistemit te E-Prokurimit të parashtruar me datë 27.12.2022 pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511,** Komisioni i vlerësimit në përbërje të Flutura Fetahaj, Armend Vehapi, Behram Mazreku dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Burim Koraqi, nxjerr këtë:

VENDIM

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZUAR

I. **Refuzohet kërkesa e propozuar për shqyrtim si e pabazuar,** e Operatorit Ekonomik **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k** - lidhur me aktivitetin e prokurimit:" **Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511,** të shpallur nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

II. **Vërtetohet,** vendimi i Autoritetit Kontraktues - MINT, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues per aktivitetin e prokurimit lidhur me tenderin:" **Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511**

III. **Autorizohet,** Autoriteti Kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , që të respektoj vendimin per procedurën e prokurimit sipas LPP-së.

IV. **Obligohet,** Autoriteti Kontraktues – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , që kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar të ja komunikoj parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

V. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i detyrueshëm për autoritetin kontraktuese dhe duhet të zbatohet menjëherë.

VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Si Autoritet Kontraktues Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) me datën 15.02.2022 ka tenderuar në procedurën hapur tenderin: "**Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511**, sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237.

Në procesin e hapjes me datë 18.10.2022 kemi pranuar pesë (5) oferta nga operator ekonomik të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Komisioni i vlerësimit pasi ka bërë vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave respektivisht ka ardhur në përfundim se operatori **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k** nuk është në përputhëshmëri të plotë me të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktruar në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht tek kërkesa e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate:

1.Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akces në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00 € .

Më datë 22.12.2022 janë njoftuar me njoftimin për tenderuesit e eleminuar dhe me të njëjtën datë është ngritur vendimi mbi njoftimin e autoritetit kontraktues për këtë procedurë të prokurimit përmes platformës së E-prokurimit të KRPP-së.

Me datë 27.12.2022 kemi pranuar kërkesën për Rishqyrtim sipas kërkesës së tij, me datë 28.03.2022 ankesë/kërkesën për rishqyrtim të vendimit të AK-MINT , nga **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k** -me pretendimin se është shkelur: Neni 1 Qellimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë

Pas pezullimit të këtij aktiviteti me datë 28.12.2022, sipas dispozitave ligjore të LPP-së të nenit 108/A, dhe në përputhje nenin nenin 8.1.1 pika (ii) të regullave për parashtrimin e ankesave të nxjerra nga KRPP-ja; Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar pikat e ankesës duke konstatuar se :

Pikat e ankesës lidhur me Nenet lart shënuar, asnjena nga këto pretendime nuk qëndrojnë pasi OE ne oferten e tij ka prezantuar dokumentacionin e bankës ku i kane munguar te dhenat kryesore te cilat i kemi paraqitur edhe ne njoftimin per eleminimin tuaj nga kjo procedure, ndresa tek Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti kjo nuk qendron fare sepse ju veq se jeni tenderues i eleminuar kurse sa i perket Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë AK-MINT sipas legjislacionit ne fuqi LPP-se dhe UOPP qe eshte miratuar në këtë vit nuk mund të kërkojë sqarime shtesë per dokumentacionin ekszistues citojme:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Mbi bazen e kesaj ju ne kerkesen per Rishqyrtim keni ofruar dokumentin e bankes jo ne perputhej me legjislacionin ne fuqi sepse data e ofrimit te ketij dokumenti eshte jo vetem se para hapjes se ofertave por edhe pas permbylljes se procesit qe ka rezultuat me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues pra me date 22.12.2022 ndresa ju me kete dokument jeni pajisur pas pranimit te njoftimit si tenderues i eleminuar pra me date 23.12.2022 qe me kete rast

eshte krijuar nje dokument i ri edhe ne daten e dokumentit por edhe ne numrin e protokolit pas mbylljes se procesit , gjitheashtu me kete rast ju vetem se po e pranoni se nje dokument te tille zyrtar nuk e keni ofruar ashtu sic eshte kerkuar, per korrektësin e procedures edhe pse ju keni ofruar dokumentin e dates 23.12.2022 nga banka ne brendesi te tij kemi kunderthenien e kjarte sepse ketu thuhet qe Leter mbeshtetja eshte nenshkruar nga Analisti i Bizneseve Berat Duraku si person pergjegjes ndresa ne dokumentin e bankes qe ju keni prezantuar ne oferte askund nuk permendet emri dhe mbiemri i tij por gjitheashtu ai dokument nuk ka as date te protokollimit si dokument ashtu sic kjo bank i ka rregullat e brendëshme qe iu referohet dispoziatave ligjore te Bankes Qendror te Kosovese. Si krashasim te ketijj dokumenti kemi marre ofertat e OE te tjerë pjesëmarres ne te njejten procedure per te njejten banke dhe shifet kjarte se dallojne keto dokumente pra nuk jane te formatit njejte per nga menyra e leshimit te dokumentit dhe se nuk mund qe banka e njejte te kete standarte te ndryshme per OE te ndryshem per dokumentin e njëjtë.

Nga e gjitha qe u tha me larte deklarojme se komisioni ka bere vleresimin e ofertave ne menyre te argumentuar të drejtë dhe korrekte duke trajtuar të gjithë OE pjesëmarrës në mënyrë të barabartë duke vlerësuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në plotësimin e secilës kërkesë dhe kriter në dosjes konform legjislacionit ne fuqi ,dhe me këtë rast ju si oferutes keni rezultuar se jeni tenderues i eleminuar per arsyen e lartëcekur.

Siç u tha me lartë si AK-MINT ka bere vlerësimin e ofertave duke i shqyrtuar te gjitha pikat e ankesës të dorëzuar nga **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k**, dhe se procesi i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave eshte bere në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, UOPP-së dhe akteve tjera nënligjore dhe në respektim të plotë të kritereve dhe kërkesave të specifikuara në dosje të tenderit.

Prandaj sipas dispozitave ligjore të LPP-së të *nenit 108/A*, dhe në përputhje *nenin 8.1.1 pika (ii) të rregullave për parashtrimin e ankesave të nxjerra nga KRPP-ja;* ***Autoriteti Kontraktues e refuzon kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.***

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Prishtinë
28.12.2022

Burim Koraqi
zv/Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Vendimi i dërgohet:
- *OE ankues*
- *Të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet,*
- *Divizionit të Prokurimit,*
- *Zyrës së Sekretarit,*
- *Arkivit të MINT*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE
No./Br./No. 7982/03 Nr.i faqës/Br.str./No.pg 1
Data/Datum/Date 28.12.22
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Datë : 28/12/2022

Në mbështetje të nenit Neni 108/A pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, it i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 6 të Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkeses për Rishqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **Invest Pro SHPK & Trasing Group Sh.p.k.** me datë 27.12.2022 pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit: **Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511,** Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, nxjerr këtë:

VENDIM
MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

I. Pezullohet aktiviteti i prokurimit:**"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV" - MINT204-22-10111-058-511,**

II. Autoriteti Kontraktues, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

III. Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe në ketë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftoj me shkrim të gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

IV. Vendimi për pezullim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë,
28.12.2022

Burim Koraqi
zv/ Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Vendimi i dërgohet:
- *OE ankues*
- *Të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet,*
- *Divizionit të Prokurimit,*
- *Zyrës së Sekretarit,*
- *Arkivit të* MIINT.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**204-22-10111-5-1-1**
Nr i brendshëm	**MINT204-22-058-511**

Sa i përket tenderit për

"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

(Invest Pro Sh.p.k. & Trasing Group Sh.p.k.)

(Rruga Uglarit p.n. Fushe Kosove)

(Fushë Kosove) *(12000)*

(049/955-735) *(Numri i Faks-it)*

(Rijad Ramadani)

(investprorks@gmail.com)

SH.P.K. INVEST PRO Fushë Kosovë

(27.12.2022) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"

Njoftimi per kontrat i publikurar me daten 04.10.2022

Nurmit i prokurimir 204-22-10111-5-1-1
Kodi i tenderit 18102022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- - Neni 1 -i LPP-së - Qëllimi
- - Neni 6 –i I LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- - Neni 7 -i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- - Neni 59 -i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- - Neni 72 -i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kerkojm nga AK qe ta rishqyrtoj me vemendje dosjen e konzorciumit te ofruar nga ne.
Ne pretendojm se i plotesojm kushtet dhe kriteret e kerkuara nga AK dhe për piken te cilen jemi eleminuar e posedojm ne dosjen e ngakuara.
Ne konfirmojm se dokumenti i leshuar nga Banka Kombetare Tregtare me datën 14.10.2022 lidhur me mbeshtettjen bankare është dokument origjinal nga Banka e lartecekur, ku te njejtin mund ta kerkoni si informate shtes edhe në banken perkatese.
Ne kemi marrur edhe nje konfirmim zyrtar nga banka lidhur me dokumentin per te cilin jemi eleminuar dhe te njejtit pra BKT konfirmon se dokumenti eshte zyrtar dhe i leshuar nga banka perkatse me te dhenat e nevojshme .
Ne vertetimin e kerkuar janë te specifikuara gjitha shenimet se nga kush është leshuar dokumenti i dates 14.10.2022.
Konfirmimin e dokumentit mund ta gjeni bashkengjitur në kerkesen për rishqyrtim.

Ne si konzorcium kerkojm qe te pezullohet vendimi i dates 22.12.2022 per proceduren ne fjale **"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"**, nga AK **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** dhe lenden ta kthej ne rivlersim duke i marr per baze faktet te cilat ju argumentuam dhe qe ta anuloj vendimin per shpalljen fitues te OE "Pro &Co Group Sh.p.k." duke formuar komision te ri per rivlersim qe te vertetoj dëshmit tona.

Amdaj kerkojm nga Autoriteti Kontrtaktues qe :

Te **APROVOJE** – si të bazuar kërkesen për rishqyrtim të Grupit te OE ***Invest Pro Sh.p.k. & Trasing Group Sh.p.k.***

Te **ANULOJ** - NJOFTIMIN për Dhënje të Kontrates dhe lënden ta kthejë në Rivlerësim duke na shpallur fitues neve si Grup I OE sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat e njeoftimit per kontrat dhe DT.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Jane bere deme materiale dhe jo materiale, ku perfshin shpenzimet për stafin i cili ka bere pregaditjet per oferten, shpenzimet e sigurimit etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

BKT Kosovë
Dega: Skënderaj
Data: 23.12.2022

Prot.no 753 / 937

VERTETIM

Me ane te ketij dokumenti vertetojme se Leter Mbeshtetja e leshuar me daten **14.10.2022** per klientin **Trasing Group SH.P.K.** me **NUI 810514275** eshte leshuar zyrtarisht nga banka BKT Kosova dega Skenderaj.

Kjo Leter Mbeshtetese eshte nenshkruar nga Analisti i Bizneseve - Berat Duraku i cili eshte kompetent per leshimin e ketij dokumenti.

Leter Mbeshteteja eshte per projektin me titull **" Ndërtimi infrastruktures fizike te Zones Ekonomike ne Qylagë – Faza e IV-te " me nr te prokurimit: 204-22-10111-5-1-1 dhe numer i brendshem MINT204-22-058-511.**

BKT Njësia SKENDERAJ
23 DEC 2022
E 009 / 753

Vertetuar nga:
Ast. Operations Menager
Mihane Veliqi

BANKA KOMBETARE TREGTARE

BKT Kosovë
Dega: Skënderaj
Data: 14.10.2022

LETËR MBESHTETËSE

Me ane te ketije dokumenti, ju konfirmojme se: kompania **"TRASING GROUP SHPK"** me NUI: **810514275**, ka limit kreditorë te aprovuar ne banken tone, mjaftushem per te mbuluar shumen e investimit prej **100,000 €**, per projektin me titull: **"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"**, me numer te prokurimit: **204-22-10111-5-1-1** dhe numri i brendshem: **MINT204-22-058-511.**

BANKA KOMBETARE TREGTARE KOSOVË SHA
NJËSIA SKENDERAJ

Zyrtari i bankes

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ *PUNË* ☐ *FURNIZIM* ☐ *SHËRBIME*

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 27.09.2022

Nr i Prokurimit	**204-22-10111-5-1-1**
Nr i brendshëm	**MINT204-22-058-511**

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**		
Adresa Postare: **Rr "Muharrem Fejza" p.n Lagja Spitalit**		
Qyteti: **Prishtinë**	Kodi postar: **10000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Bexhet Asllanaj**	Telefoni: **038/20036535**	
Email: **bexhet.asllanaj@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): **https://mint.rks-gov.net/**		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☒ **Punë**	☐ **Furnizime**	☐ **Shërbime**
☒ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Qylagë-Lipjan

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45000000-7

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët *(nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 726 895,80

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Komplet sipas projektit

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë **120** (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10% e vlerës së kontratës** % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L – 042 , Neni 65, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit. 2. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore te lëshuar nga Gjykata Themelore- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër se 30 ditë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës). 3 . Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës).**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklarata nën betim-kërkohet origjinal 2. Vërtetimi nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar noterizuar. 3. Vërtetimi nga ATK - kërkohet origjinal apo kopje.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **1. Një deklaratë e nënshkruar nga autoriteti i përshtatshëm publik në vendin tuaj të themelimit të regjistrimit tuaj në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës, duhet të dorëzohet, së bashku me përshkrimin e veprimtarive primare dhe sekondare të kompanisë ku edhe përfshihen natyra e ngjashm 2. Certifikata e TVSH-së 3. Certifikatën e Numrit Fiskal**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Kopje e certifikatës së biznesit. 2. Certifikata e TVSH-së-(kopje). 3. Certifikata e Numrit Fiskal (kopje).**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **1.Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës ose akces në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00€ 2.Qarkullimi mbi gjendjen financiare gjatë 3-tri viteve te fundit të jetë me se paku 1,400,000.00€.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia – 1 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt. Dëshmia -2 Raportet mbi gjendjen financiare tri vitet e fundit te audituara nga një kompani e licencuar e auditimit ose auditor i licencuar te prezantohet kopja e noterizuar e licencës se auditorit kompanisë audituese. a)Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tre (3) vitet fundit**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **1. Operatori Ekonomik duhet ofroj listën e kontratave per gjate 3-tri viteve prej datës se njoftimit per kontarte do të jete vlera prej se paku 1,000,000.00 euro që ka ndërtuar realizuar projekte kapitale, që në vehte përmbajnë ujësjellës, kanalizime, rrugë, elektrikë, etj, dhe të përcjelluar me referenca për kontratat e njëjta.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Deshmia-1 Lista kontratave duhet te jete origjinal e vulosur dhe nënshkruar prej kompanisë si dhe kopja e referencave për kontratat e njëjta.**

2.Kompania ekzekutuese ndërtuese duhet të këtë 2.1.Një Ing. dip. Konstruktiv, 2.2.Një Ing. dip. Hidroteknik, 2.3.Një Ing. dip. Elektro, 2.4.Një Ing. dip. Gjeodezi, 2.5.Një Ing. dip. i Infrastrukturës, 3 .Të emëroj me vendim një menaxher të projektit dhe të bashkëngjis diplomën e menaxherit, CV dhe kontratën marrëveshjen për realizim të këtij projekti.	Dëshmia–2 Diplomë universitare-kopje, Përvoja e punës së paku dy vite përvojë pune për inxhinierët me fakultet pesëvjeçar, derisa së paku katër vite përvojë pune për ata me sistem bachelor. Përvoja e dëshmuar me CV (të nënshkruar) dhe kontratë-kopje, apo me CV (të nënshkruar) dhe letër referencë-kopje. Kompania duhet të ofroj dëshmi për stafin e lartë cekur që ka kontratë të rregullt të punës ose marrëveshje paraprake me stafin për realizmin e projektit në fjalë. Dëshmia–3 Vendimi i kompanisë Origjnal dhe sipas kerkese.
4. Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë. (në rast konzorciumi atëherë duhet të jenë të paisur secili antar i konzorciumit veç e veç për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës).	Dëshmia–4 Dëshmia Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.
5. Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt ; Një listë prej së paku Minimum 20 puntorë.	Dëshmia–5 Dëshmia Lista e puntorëve e vulosur dhe nënshkruar dhe te dëshmuar me ATK,
6.Kërkesa.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit Operatori ekonomik së paku duhet të paraqes listën e pajisjeve për 3-kamiona me peshë bartëse 10 e më shumë m3, 1-eskavator mbi 20 tona 1-eskavator 5-7 tona 1-skipë, 3-bagera, 1-grejder, 2-valaka	Dëshmia–6 Lista e pajisjeve – mjeteve të punës që OE duhet të ketë në emër të kompanisë dhe të dëshmohet me kopje të librezave ose të ketë të kontraktuar (me qira) dhe të dëshmohet me kontratë marrëveshje për shfrytëzim dhe me kopje të librezave.
7. OE duhet te jete i licencuar si gurëthyes per zhavor.	Dëshmia–7 Dëshmia Për gurëthyesin duhet të sillet licenca per aktivitete te veqanta e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim te noterizuar ne emer te projektit.
8. OE duhet të ketë bazë për prodhimin e betonit	Dëshmia–8 Deshmia Për bazen e betonit duhet të sillet dëshmia Licenca e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Ne rast se OE nuk posedon bazën e prodhimit, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim te noterizuar ne emer te projektit

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☐

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ Jo ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ **Jo** ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

ose

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,
Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*
i
i

Po ☐ Jo ☒
Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR
Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:*

***data* 18.10.2022 *koha* 14:00:00 *vendi* E-prokurim**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:
☒ Po ☐ Jo

Nëse po, jep arsyetim **Duke pasur parasysh se projekti eshte mjaft i madhe dhe jemi ne fund vit dhe pasiqe tanimë kane përfunduar marrëveshja ndërmjet komunës se Lipjanit dhe Ministrisë, si dhe është dorëzuar projekti dhe paramasa nga Komuna, andaj me qellim te respektimit te marreveshtjese dypalësh e eshte mandat 2 vjeqar qe te arrijmë sado pak kontraktimin e operatorit ekonomik dhe fillimin e punimeve lidhur me kete projekt, duke pasur parasysh se kemi buxhet te planifikuar dhe te zotuar.**

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:
Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **5000 Euro**
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **150** *apo* muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:
Deri më: data: ditët **120** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 18.10.2022 koha 14:00:00 vendi E-prokurim

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"

Numri i aktivitetit te prokurimit: MINT204-22-10111-058-511

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I., Shiroke, 23000, Suhareke	629113,72 €
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Imer Krasniqi, 20400, MALISHEVË	689363,20 €
3.	Pro & Co Group SH.P.K., Rr.Marigona Residenc Llapllasellë p.n, 10500, Graqanicë	688835,12 €
4.	Benita Company, Gremnik, 32000, Klinë	713444,64 €
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K.; Trasing Group Sh.p.k., Fushe Kosove, 13000, Rr. Uglarit	633358,58 €

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë **shpërblen** me kontratë OE " **Pro & Co Group SH.P.K.**" në vlerë totale të ofertës **688,835.12 €**

Prishtinë
22.12.2022

Burim Koraqi
Zv/Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[1]

22.12.2022 Prishtinë

Ministria e Industrisë, Ndremarresise dhe Tregtisë –Prishtinë

Pro & Co Group SH.P.K

Nr. i Prokurimit:	**MINT204**	**2**	**2**	**10111/058**	**5**	**1**	**1**

Titulli: Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar *[tenderin me çmimin më të ulët]* si përgjigje ndaj *[njoftimit të kontratës]* për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj **688,835.12 €** dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te

Me respekt,
Burim Koraqi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

[1] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [5]

22.12.2022 Prishtinë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Prishtinë

Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K.; Trasing Group Sh.p.k.

Nr. i prokurimit:	**MINT204**	**2**	**2**	**10111/058**	**5**	**1**	**1**

Titulli: Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim"LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1.**Ju keni ofruar letër mbështetjen nga banka BKT mirëpo ketij dokumenti të bankës i mungojnë edhe disa te dhëna te rëndësishme: i mungon numri i protokollit te lëshuar nga kjo bank sipas rregullave si dokument zyrtar i bankës, i mungon emri dhe mbiemri i zyrtarit që ka aprovuar këtë dokument apo emri dhe mbiemri i menaxherit në pikën e lëshuar (Skenderaj).**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Burim Koraqi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

[5] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [2]

22.12.2022 Prishtinë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Prishtinë

Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I

Nr. i prokurimit:	MINT204	2	2	10111/058	5	1	1

Titulli: Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim"LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1. Në kuadër të ofertës tuaj ju nuk keni ofruar raportet mbi gjendjen financiare për tri vitet e fundit të audituara ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.
2. Në kuadër të ofertës tuaj ju nuk keni ofruar listen e stafit mbështetës ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.
3.Planin dinamik qe keni ofruar nuk eshte ashtu sic eshte kërkuar ne njoftim per kontrate si periudhë e përfundimit të projektit per 120 dite, mirëpo ju keni ofruar planin me përfundimin e punimeve për 24 muaj.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Burim Koraqi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

[2] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [3]

22.12.2022 Prishtinë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Prishtinë

Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM

Nr. i prokurimit:	MINT204	2	2	10111/058	5	1	1

Titulli: Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim"LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1. **Në kuadër të ofertës tuaj ju keni ofruar dokumenti e mbështetjes nga banka per akces ne kredi mirëpo ky dokument eshte drejtuar per nje Institucion tjetër (per Ministrise e Infrastruktures) dhe jo per AK-MINT,poashtu edhe mbeshtjetja eshte e kushtëzuar nëse klienti i plotëson kushtet dhe kriteret e brendëshme të bankës.**
2. **Në kuadër te ofertës tuaj mungon edhe licenca e kompanisë audituese.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Burim Koraqi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

[3] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [4]

22.12.2022 Prishtinë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë –Prishtinë

Benita Company

Nr. i prokurimit:	MINT204	2	2	10111/058	5	1	1

Titulli: Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim"LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1. **Pas kërkesës per sqarime shtesë ju nuk e keni ofruar licencën e kompanisë per vlerësimin e riskut ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.**
2. **Pas kërkesës per sqarime shtesë ju nuk e keni ofruar marrëveshjen për gurëthyesin dhe zhavor te noterizuar ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,
Burim Koraqi

_____,
(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

_____
(Nënshkrimi)

[4] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	204-22-10111-5-1-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	MINT204-22-058-511		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
18.10.2022	18.10.2022, 14:00:00	18.10.2022, 14:00:00	E-prokurim	5

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik B FAMIS SH.P.K.; Bujar Shabani B.I., Shiroke, 23000, Suhareke	5/2022	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"	PO	533147,23	629113,72	JO
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Agim Morina B.I.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, Imer Krasniqi. 20400, MALISHEVË	M. 18.10.2022	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"	PO	584206,10	689363,20	JO
3.	Pro & Co Group SH.P.K., Rr.Marigona Residenc Llapllasellë p.n, 10500, Graqanicë	204-22-10111-5-1-1	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"	PO	583758,58	688835,12	JO
4.	Benita Company. Gremnik. 32000. Klinë	001 MINT	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"	PO	604614,10	713444,64	JO
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik INVEST PRO SH.P.K.; Trasing Group Sh.p.k., Fushe Kosove, 13000, Rr. Uglarit	18102022	"Ndërtimi infrastrukturës fizike të Zonës Ekonomike në Qylagë – Faza e IV"	PO	536744,57	633358,58	JO

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Burim Koraqi		18/10/2022
Dafina Hasani		18.10.2022

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Bexhet Asllanaj

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.